



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:219851

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05707305

Ac.nr.3657/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Lumni Sallauka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Sh....., B....., B..... dhe I..... M.... që të gjithë nga Prishtina, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Xh..... B.... avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna Prishtinë, të cilën e përfaqëson F..... B.... sipas autorizimit, për kompensim nga eksproporijimi, duke vendosur sipas ankesës së paditësve, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2394/08, të datës 02.03.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më 08.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësve Sh....., B....., B..... dhe I.....M..... që të gjithë nga Prishtina, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2394/08, i datës 02.03.2020, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar C.nr.2394/08 të datës 02.03.2020 ka vebdosur në këtë mënyrë: I.REFUZOHET padia dhe kërkesëpadia e paditësve Sh....., B....., B.....dhe I.....M..... që të gjithë nga Prishtina, me të cilën kanë kërkuar që në emër të kompensimit të palujtshmërive të ekspoprijuara me aktvendimin e Sekretariatit për Financa i Kuvendit Komunal-Prishtinë nr. 05 nr.463-32/73 dt.24.07.1974, ng.kad.nr.2745/13 në sip. S=405 m2 dhe ng.kad.nr.2745/15 në sip S=500 m2, që të dyja në vendin e quajtur “Lagja e Muhagjerëve”, të evidentuara në qertifikatën mbi të drejtat e palujtshmërisë UL-71914059-07316 ZK Prishtinë, evidentuar në emër të shfrytëzimit K..... (I.....) M..... nga Prishtina, të detyrohet e paditura Komuna Prishtinë, t’ia kompensoj shumën prej 316,750.00 €, me kamatë prej 8%, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm, si e pa bazuar. II.Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij Aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë kanë paraqitur paditësit, për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë dhe të

gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet akesa dhe të ndryshohet Aktgjykimi i atakuar dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditësve apo i njejti të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

E paditura ka paraqitur përgjigje në ankesë, me propozim që Aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

### **Ankesa e paditësve është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit me padi ka kërkuar kompensimin e dëmit në emër të shpronësimit, ndaj të paditurës.

Duke vepruar sipas padisë së paditësve, gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka nxjerrë Aktgjykimin e atakuar. Në arsyetim të Aktgjykimin të atakuar ndër të tjera theksohet se nga faktet e parashtruara dhe provat e propozuara, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike se palët paditëse nuk dispononin me aktvendimin e Sekretariatit për Financa i Kuvendit Komunal-Prishtinë nr. 05 nr.463-32/73 dt.24.07.1974 për ekspoprijim, mirëpo në mes të palëve ndërgjyqës nuk ishte kontestuese se me këtë aktvendim është ekspoprijuar ng.kad.nr.2745/12, në vendin e quajtur “Mahalla e Muhaxherëve”, në Prishtinë, në sip. 0,06.00 ha e regjistruar sipas fletës poseduese nr.1648 ZK Prishtinë, dhe për të njëjtën është bërë kompensimi nga BVI për rregullimin tokës Ndërtimore, përfituesi i ekspoprijimit, pronarit të deri athershëm Kamber Morina. Këtë palujtshmëri i ndjeri K.....M..... e kishte blerë nga i ndjeri Sh..... G..... nga Prishtina, e që kjo u vërteua nga aktgjykimin në bazë të pranimit i Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.4/72 dt. 09.03.1973, me të cilin janë obliguar të paditurat B..... Z..... dhe M..... S.....-trashëgimtare e të ndjerit Sh..... G....., që paditësit t’ia bartin këtë palujtshmëri në emër të tij. Nga procesverbali i nënshkruar në Sekretariatin për financa të KK Prishtinë me nr.673.74-2-28 i dt.22.09.1980, u vërteua se është caktuar ekzekutimi i dhunshëm, i vendimit të eksproprijimit të plotfuqishëm 05-463-32/73 të dt.24.07.1974 në palujtshmërinë e shfrytëzuesit faktik K.....M..... Në bazë të këtij procesverbali shfrytëzuesi i më parshëm K..... M....., në sancë dëgjimi ka deklaruar se nga B..... Z..... dhe M.....S..... nga Prishtina, ka blerë palujtshmërinë ng.kad.nr.2745/12, në sip. 0,06.00 ha, e që vërtetohet edhe nga aktgjykimi në bazë të pranimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.4/72 dt. 09.03.1973, ashtu që ka deklaruar se nuk pajtohet me ofertën e shfrytëzuesit të ekspoprijimit e vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 42.222,00 dinar, për arsye se kompensimin e ka konsideruar të ulët. Me këtë përfaqësuesi i shfrytëzuesit të ekspoprijimit ka konstatuar se shkresat e lëndës i dërgohen Gjykatës Komunale në Prishtinë, për caktimin e kompensimit në procedurë jo kontestimore. Më pastaj është zhvilluar procedura pranë gjykatës, ku në procedurë jo kontestimore është marrë aktvendimi C.nr.1435/80 dt. 26.04.1984 i cili është vërtetuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë me vendimin Ac.Gz.nr.599/84 dt.12.10.1984, me anë të cilëve K..... M..... është kompensuar sa i përket palujtshmërisë ng.kad.nr.2745/12, në sip. 0,06.00 ha, për patundshmëri, pem, perime,

dhe rrethoj të oborit. Ndërsa nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Ac.nr.779/86 dt.27.02.1987, me të cilin janë refuzuar si të pabazuara ankesat e të paditurave Komuna dhe BVI, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë C.nr.440/82 dt.08.07.1986, gjykata ka vërtetuar se paraardhësi i paditësve Kamber Morina, është kompensuar edhe në emër të demë shpërblimit për shkak të rrënimit të objektit në mënyrë të kundërligjshme, të pronës së tij ng.kad.nr.2745/12, në sip. 0,06.00 ha në shumë prej 6.003.649 dinar me kamatë prej 7.5 % prej dt.25.08.1981 e deri me dt.03.08.1985, ndërsa prej kësaj date me kamatë ligjore që paguhet për mjetet e afatizuara për një vit pa destinim të veçant, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 228.100 dinarë, duke u bazuar në atë se duke ia rënuar shtëpinë, organi i të paditurës së parë ka vepruar kundër parimit mbi mos shkaktimit të dëmit tjetrit nga neni 16 të Ligjit mbi marrdhëniet e detyrimeve (Fletorja zyrtare RSFJ nr.29/78). Në bazë të shkresës dt. 09.08.2011, e paditura Komuna Prishtinë ka deponuar fletën poseduese nr.1648 e datës 30.01.1973, me numër të parcelës 2745, në sipërfaq prej 1.15.67 ha, nga e cila u vërtetua se në këtë kohë kjo palujtshmëri si tërësi, evidentohet në emër të pronareve Zeqiri Sh..... B..... dhe S..... Sh.....M..... me nga ½. Kontestuese në mes të palëve ndërgjyqës ishte fakti se si jo vetëm palujtshmëria e ekspoprijuar ng.kad.nr.2745/12, për të cilën pronari K..... M..... është kompensuar si u cekë më lartë, por se edhe dy ngastrat tjera ng.kad.nr. 2745/13 dhe 2745/15, e për të cilat paditësit nuk ka paraqitur dëshmi se si paraardhësi i tyre është bërë titullar i tyre, të njëjtat evidentohen edhe më tutje në emër të K..... M..... Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit të gjeodezisë dt. 18.01.2012, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike se kontesti ka të bëjë me ng.kad. nr.2745/13 në sip S=405 m2 dhe 2745/15 në sip S=500 m2, e në sipërfaqe të përgjithshme prej S=905 m2, që të dyja vendi i quajtur “Lagja e Muhagjerëve”, të evidentuara në qertifikatën mbi të drejtat e palujtshmërisë UL-71914059-07316 ZK Prishtinë, evidentohen në emër të shfrytëzuesit K.... (I....) M..... nga Prishtina. Që të dy këto ngastra sipas gjndjes faktike, janë të mbuluara me infrastrukturë, rrugë, trotuar dhe gjelbrim, dhe një pjesë objekti banesor me tazhitet P+8. Lidhur me historiatin e këtyre ngastrave kadastrale Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi në Prishtinë nuk ka të dhëna, pasi që është bartur në Krushevc të Sërbisë. Bashkë me raportin është paraqitë edhe skica e matjeve gjeodezike sipas gjendjes faktike dhe gjendja në planin kadastral në përpjesë P=1:300. Me aktvendimin e dt.17.09.2012, kjo gjykatë e ka ndërprerë gjykimin në këtë qështje juridiko civile për shkak të mungesës së dokumentacionit kadastral, sipas propozimit të autorizuarit të paditësve me parashtrësën e dt. 19.05.2017, është bërë vazhdimi i procedurës në bazë të provave të prezantuara. Përgjatë procedurës shqyrtimeve të mbajtura paditësit janë tërhequr nga kërkesë padia për kompensimin e ng.kad.nr.2745/12, meqë kanë theksuar se për të njëjtën janë kompensuar nga e paditura e dytë në kohën e eksporijimit dhe ndaj kësaj të paditure NPB në Prishtinë, edhe në seancën e shqyrtimit kryesor të qështjes. Ndërsa kanë mbetë pranë kërkesëpaditë për kompensim nga baza e ekspoprijimit për ng.kad.nr. 2745/13 dhe 2745/15 dhe atë në shumën e përcaktuar sipas ekspertizës së ekspertit Bujar Pallaska ku në ekspertizën e dt.29.02.2012, ka caktuar vlerën e këtyre palujtshmërive në shumë prej 316,750.00 €. Paditësit nuk e kanë bërë të besushme kërksëpadinë e tyre, pasi që gjykatës nuk i ofruan prova se mbi bazën e cilit veprim juridik paraardhësi i tyre K.....M....., është regjistruar si shfrytëzues në librat kadastral i ng.kad.nr. 2745/13 dhe 2745/15. Sipas dispozitës së nenit 37 të LMTHJP është paraparë që pronari mundet me padi të kërkoj nga nëdorësi(poseduesi) kthimin e sendit individualisht të caktuar (par.1 i këtij neni) në rastin konkret kompensimin e sendit-pronës së ekspoprijuar, por medoemos duhet të provoj se e ka të

drejtën e pronësisë së sendit kthimin-kompensimin e të cilit kërkon. Prezumimet për fitimin juridikisht të vlefshëm të drejtës së pronësisë në bazë të punës juridike sipas nenit 33 të këtij ligji janë: ekzistimi i bazës së vlefshme juridike (iustus titulluas), pronësia e personit të mëparshëm dhe mënyra ligjore e dorëzimit të sendit(modus acquirendi). Ndërsa nga provat deponuara si nga e paditura e parë ashtu edhe nga e paditura e dytë, është vërtetuar se pronar faktik dhe juridik të këtyre ngastrave para K.... M....., ishin Z..... Sh.... B..... dhe S..... Sh..... M..... me nga ½ dhe të njëjtat për këto palujtshmëri janë kompensuar sipas ofertës nr.637/73-28 dt. 08.05.1975 të bërë nga Sekretariati i Financave KK Prishtinë, shfrytëzuasit të mëhershëm të palujtshmërisë sipas fletës poseduese nr.1648 ZK Prishtinë, si ng.kad.nr.2745, në sip. 1.15.67 ha dhe atë në ½ Sadik Magbule, në kuptim të Ligjit për ekspoprijim, në shumën prej 78.070,50 dinar. Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar kërkesë padinë e paditësve, ngase paditësit më asnjë provë nuk i kanë mbështet pretendimet e tyre sipas të cilave paraardhësi K..... M....., të ketë blerë palujtshmërit ng.kad.nr. 2745/13 dhe 2745/15, nuk ofruan ndonjë marrëveshje qoftë të shkruar apo gojore, ani pse këto ngastra evidentohen në emër të K..... M..... si shfrytëzues, të njëjtit kanë pas për obligim që të dëshmojnë mënyrën e regjistrimit në regjistrat civil, ashtu siç u vërtetua për ng.kad.nr.2745/12.Për të vërtetuar këto fakte paditësit nuk ka prezantuar ndonjë provë gjatë zhvillimit të procedurës e as që kanë propozuar që të merret ndonjë provë me anë të dëgjimit të dëshmitarëve për të argumentuar këtë pretendim. Për gjykatën nuk është e mjaftueshëm vetëm të citohen faktet, mirëpo të njëjtat duhet të provohen, edhe atë bazuar në nenin 7.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore “*Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*”, ndërsa me nenin 319.1 të këtij ligji është paraparë : “*Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*”. Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me shpenzimet procedurale ka vendosur duke u bazuar ne dispozitat 449, 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale, sepse paditësve si gjyq humbës nuk iu takon e drejta në shpenzime procedurale, ndërsa e paditura nuk ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatë së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-ës dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-ës, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, e as shkeljeve të tjera nga neni 182.2, pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160, par. 4 dhe 5 të LPK-ës, meqë gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat që i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke bërë kështu që dispozitivi dhe arsyetimi, si dy pjesë përbërëse të aktgjykimit, të jenë në harmoni logjike dhe juridike me njëra

tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësve, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontest, në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Kështu, gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme për mungesën e bazës juridike të kërkesëpadisë. Si rrjedhojë e këtyre, Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket vërtetimit të mungesës së bazës juridike të kërkesëpadisë së paditësve.

Gjykata e shkallës së parë ka aplikuar në mënyrë të drejtën dispozitat materiale, për shkak se e pditura pronat objekt shqyrtimi ia ka paguar pronarëve paraprak përmes ofertës Nr.637/73-28 të datës 08.05.1975 të bërë nga Sekretariati i Financave KK Prishtinë. Në rastin konkret kemi shuarje të marrëdhënieve të detyrimit në mënyrë vullnetare (me përmbushjen e detyrimit për parcelën objekt shqyrtimi nga ana e të paditurës, përmes ofertës së lartë cekur). Shuarja e detyrimeve me përmbushje (ekzekutimi, pagesa) është mënyra më e natyrshme e realizimit të të drejtave dhe detyrimeve nga palët ndërgjyqëse. E paditura ka përmbushur në tërësi detyrimin e saj ndaj pronarëve paraprak të parcelës objekt shqyrtimi. Përmbushja e detyrimit e ka kuptimin e pagesës ose të ekzekutimit, e cila ka ndodhur nga ana e të paditësve për të gjithë pronarët paraprak Z..... Sh..... B..... dhe S.....Sh..... M....., të cilët kanë qenë pronar të parcelave objekt shqyrtimi në pjesë ideale 1/2.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për pabazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditësve është i drejtë dhe i argumentuar. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë edhe për zbatimin e drejtë të dispozitave materialo - juridike në të cilat është thirrur me rastin e vendosjes, nga edhe ka rrjedhur pabazueshmëria e kërkesëpadisë së paditësve, pasi që zbatimi i këtyre dispozitave në përputhje me konstatimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, argumenton plotësisht qëndrimin e kësaj të fundit se kërkesëpadia e paditësit në rastin konkret është e pathemeltë. Për këtë arsye gjykata e shkallës së dytë gjen se ankesa e paditësve në rastin konkret është e pabazuar.

Po ashtu është vërtetuar edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, me arsyetim se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë është bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të paditësve, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Numri i lëndës: 2019:219851  
Datë: 20.05.2024  
Numri i dokumentit: 05707305

Ac.nr.3657/2021, datë 08.05.2024

Kryetari i kolegjit,  
Ardian Ajvazi